# PROCESI PJESËMARRËS GJATË HARTIMIT TË PLANIT RREGULLUES TË HOLLËSISHËM – Zona "Qendra e Qytetit" - Gllogoc 2023-2031



# Hyrje

Ky raport paraqet një pasqyre të zhvillimit të procesit të hartimit të Planit Rregullues të Hollësishëm Zona "Qendra e qytetit" – Gllogoc 2023-2031.

Qëllimi hapjes së shqyrtimit publik të këtij dokumenti ishte që të zhvillohen konsultime dhe që të inkurajohet pjesëmarrja transparente e publikut në procesin e hartimit të këtij dokumenti të planifikimit hapësinor që përcakton kushtet për rregullimin e hapësirave për zonën urbane të përcaktuar në Planin Zhvillimor Komunal dhe Hartën Zonale Komunale për një periudhë së paku 8 vjeçare.

Gjatë periudhës së shqyrtimit publik qytetarët e Komunës së Drenasit kanë pasur mundësi që të japin vërejtjet, komentet dhe sugjerimet, të cilat pastaj do të inkorporohen në dokumentin e Planit Rregullues të Hollësishëm për Qendrën e Qytetit – Gllogoc 2023-2031.

Shqyrtimi publik zgjati 30 ditë që nga dita e hapjes 09.03.2023-09.04.2023. Vërejtjet, komentet dhe sugjerimet mund të bëhen në librin e vërejtjeve apo përmes e-mailit zyrtar komuna.drenas@rks-gov.net si dhe duke protokolluar në sportelet e komunës.

Projekt dokumentin Plani Rregullues i Hollësishëm për Qendrën e Qytetit Gllogoc është publikuar në ueb faqen e Komunës së Gllogocit në linkun: https://kk.rks-gov.net/.../category/konsultimet-publike-al/

Ky raport është përgatitur për projektin e Planit Rregullues të Hollësishëm Zona "Qendra e qytetit" – Gllogoc 2023-2031. Pjesë e këtij raporti janë dokumentet si në vijim:

- Raporti i shqyrtimit publik
- Vendimi për fillimin e hartimit te Planit Rregullues të Hollësishëm për Qendrën e Qytetit – Gllogoc
- Vendimi për lënie në Shqyrtim Publik në Projekt-Dokumentit të Planit rregullues të Hollësishëm për Qendrën e Qytetit – Gllogoc
- Vendim për Themelimin e Ekipit Komunal për Planifikim dhe Menaxhim Hapësinor
- Përmbledhja e komenteve, rekomandimeve dhe vërejtjeve të aktiviteteve të shqyrtimit publik
- Përgjigjet për komentet nga Autoriteti Komunal për Planifikim Hapësinor.
- Foto: Hapja e Shqyrtimit Publik.

# Raport i Shqyrtimi Publik

Në mbledhjen e datës 31.08.2022 miratohet propozimi për Vendimi për fillimin e hartimit te Planit Rregullues të Hollësishëm për Qendrën e Qytetit – Gllogoc, sipas pikave të cekura në vendimin 02 Nr 030/01-46344 të datës 31.08.2022 (në vazhdim i bashkangjitur).

Në mbledhjen e datës 28.03.2023 miratohet propozimi për hapjen zyrtare të Shqyrtimit Publik për Planin Rregullues të Hollësishëm Zona “Qendra e qytetit” – Gllogoc 2023-2031, 02 Nr 400/01-14932 datë 28.03.2023 sipas pikave të cekura në vendim (në vazhdim i bashkangjitur).

Kryetari i Komunës së Gllogocit, z. Ramiz Lladrovci, me datë 09.03.2023 bëri hapjen zyrtare të Shqyrtimit Publik për Planin Rregullues të Hollësishëm Zona “Qendra e qytetit” – Gllogoc 2023-2031. Në hapje morën pjesë një numër i konsiderueshëm i qytetarëve dhe të interesuarve nga fusha të ndryshme zhvillimore që patën mundësinë të informohen rreth PRrH-së, përmes prezantimit të gjitha fazave të planit. Qëllimi i këtij prezantimi ishte që të zhvillohen konsultime dhe që të inkurajohet pjesëmarrja transparente e publikut në hartimin e këtij dokumenti strategjik multisektorial.

Në mënyrë që i gjithë procesi të jetë në hamoni me legjislacionin në fuqi janë marrë parasysh përgjegjësitë e Autoriteteve të Planifikimit Hapësinor si dhe parimet dhe procedurat për pjesëmarrjen e publikut në planifikim hapësinor , në bazë të nenit 12 duke publikuar në faqen zyrtare të Komunës.

Kryetari i Komunës i njoftoi të pranishmit se bazuar në obligimet ligjore që përcaktohen në Ligjin Nr.04 /L-174 për Planifikimin Hapësinor, Komuna e Gllogocit ka filluar me procesin e hartimit të Planit Rregullues të Hollësishëm për zonën qendër, duke pasur parasysh nevojën e planifikimit detal.

Gjatë periudhës së shqyrtimit publik, qytetarët e Komunës së Gllogocit kanë pasur mundësi që të japin vërejtjet, komentet dhe sugjerimet, të cilat pastaj do të inkorporohen në dokumentin e Planit Rregullues të Hollësishëm për periudhën kohore 2023-2031.

Kryetari Lladrovci ka falënderuar kontribuuesit e hartimit te Planit Zhvillimor Komunal siç janë: Ekipi Komunal i Planifikimit, Ekipi Këshillues i Komunitetit, Kompaninë hartues dhe të gjithë akterët tjerë të kyqur në proces.

Vendimi për fillimin e hartimit te Planit Rregullues të Hollësishëm për Qendrën e Qytetit – Gllogoc

Republika e Kosovës
Komuna e Gllogocit
Kuvendi i Komunës

02 Nr 030/01-46344 dt. 31/08 2022

Bazuar në nenin 11,12 dhe 40, të Ligjit Nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 34 pika 34.6 të Statutit të Komunës së Gllogocit, në bazë të nenit 10 paragrafi 2 nënparagrafi 2.1 të Ligjit Nr.04/L-174, për Planifikimin Hapësinor, Udhëzimit administrativ MMPH-nr.01/2018, për elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e planeve rregulluese të hollësishme. Kuvendi i Komunës së Drenasit- Gllogocit në mbledhjen e rregullt të mbajtur me **datë 31.08.2022, miraton këtë:**

## V E N D I M
## PËR FILLIMIN E HARTIMIT TË PLANIT RREGULLUES TË HOLLËSISHËM PËR QENDRËN E QYTETIT- GLLOGOC

**Neni 1**

Miratohet vendimi për fillimin e hartimit të Planit Rregullues të Hollësishëm për Qendrën e Qytetit- Gllogoc.

**Neni 2**

Planet Rregulluese të Hollësishme përcaktojnë kushtet për rregullimin e hapësirave për zona urbane apo zona rurale, siç është përcaktuar në Planin Zhvillimor Komunal dhe Hartën Zonale Komunale.

**Neni 3**

Zona për të cilën do të hartohet Plani Rregullues i Hollësishëm është Qendra e Qytetit Gllogoc dhe përfshinë një sipërfaqe prej S=110.00 Ha.

**Neni 4**

Plani Rregullues i Hollësishëm mbulon një periudhë së paku tetë (8) vjeçare.

Neni 5

Autoriteti për planifikim hapësinor është përgjegjës për zbatimin e Planit Rregullues të Hollësishëm në bashkërendim dhe bashkëpunim me autoritetet tjera përkatëse sektoriale përgjegjëse.

**Neni 6**

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MPL-ja, si dhe 7 ditë nga publikimi në Web faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi i dërgohet:
Zyrës së Kryetarit ;
Drejtorisë Përkatëse;
Zyrës së Kuvendit;
Arkivit;

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**
**Milaim Hajdari**

1

Vendimi për lënie në Shqyrtim Publik në Projekt-Dokumentit të Planit rregullues të Hollësishëm për Qendrën e Qytetit – Gllogoc

**Republika e Kosovës**
**Komuna Drenas/Gllogoc**
**Kuvendi i Komunës**

**02.-Nr** 400/01-14332 **dt.** 28.03 **2023**

Bazuar në nenin 11, 12, dhe 40, të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 34.pika 34.6, të Statutit të Komunës së Gllogocit, nenit 11 paragrafi 1, pika 1.15, nenit 17, paragrafi 5 dhe neneve 20 dhe 26 të Ligjit Nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, nenit 4 paragrafi 3 nenparagrafi 3.3, nenit 7, paragrafi 2, nenit 8, nenit 10, nenit 12 të Udhëzimit Administrativ Nr.05/2014, për përgjegjësitë e autoriteteve të planifikimit hapësinor si dhe parimet dhe procedurat për pjesëmarrjen e publikut në planifikim hapësinor. Kuvendi i Komunës së Drenasit/Gllogocit në mbledhjen e rregullt e mbajtur me datë, **28.03. 2023,** miratoi këtë:

**V E N D I M**
**PËR LËNIE NË SHQYRTIM PUBLIK TË PROJEKT DOKUMENTIT TË PLANIT RREGULLUES TË HOLLËSISHËM PËR QENDRËN E QYTETIT-GLLOGOC**

**Neni 1**
**Lloji i dokumentit të planifikimit hapësinor**

1.1. **MIRATOHET** Vendimi për lënie në shqyrtim publik të projekt dokumentit të Planit Rregullues të Hollësishëm për Qendrën e Qytetit-Gllogoc.

1.2. Projekt dokumenti nga pika 1 e këtij vendimi, përbëhet nga pjesa tekstuale dhe grafike, të cilat janë pjesë përbërëse të këtij vendimi.

**Neni 2**
**Pjesëmarrja dhe shqyrtimi publik**

2.1 Hapja zyrtare e shqyrtimit publik dhe prezantimi i Projekt dokumentit të Planit Rregullues të Hollësishëm për Qendrën e Qytetit-Gllogoc, bëhet në sallen e Kuvendit, me 14 prill 2023 në ora 14:00.

2.2 Shqyrtimi publik i Projekt dokumentit të Planit Rregullues të Hollësishëm për Qendrën e Qytetit- Gllogoc, zgjat 30 ditë, përkatësisht prej 14 prill 2023 deri me 14 maj 2023 sipas procedurave të përcaktuara me ligj.

2.3 Shpallja e shqyrtimit publik të Projekt dokumentit të Planit Rregullues të Hollësishëm për Qendrën e Qytetit- Gllogoc bëhet tetë ditë para hapjes së tij përmes mjeteve të informimit publik, përkatësisht ueb faqës së Komunës.

1

2.4 Projekt dokumenti Plani Rregullues i Hollësishëm për Qendrën e Qytetit- Gllogoc, është pjesë përbërëse e këtij vendimi dhe i njëjti publikohet në ueb-faqen zyrtare të Komunës: https://kk.rks-gov.net/gllogoc/category/shpalljet/.

2.5 Projekt-dokumenti Plani Rregullues i Hollësishëm për Qendrën e Qytetit- Gllogoc u nënshtrohet vërejtjeve, komenteve dhe sugjerimeve të publikut para se të finalizohet.

2.6 Të gjitha vërejtjet, komentet dhe sugjerimet që paraqiten nga publiku gjatë diskutimeve, me shkrim, në librin e vërejtjeve apo përmes adresës elektronike komuna.drenas@rks-gov.net, brenda afatit kohor të përcaktuar, përfshihen në raportin mbi shqyrtimin publik.

2.7 Pas përfundimit të kohëzgjatjes së shqyrtimit publik, projekt dokumenti, së bashku me një përmbledhje të shkurtër të komenteve të bëra gjatë diskutimit publik- raportin, do t'i dorëzohen Kuvendit të Komunës së Gllogocit për shqyrtim dhe miratim përfundimtar.

**Neni 3**
**Subjekti përgjegjës**

3.1. Autoriteti për planifikim hapësinor është përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi në bashkërendim dhe bashkëpunim me autoritetet tjera përkatëse sektoriale përgjegjëse.

**Neni 4**
**Kufiri i territorit**

Zona për të cilën është hartuar Plani rregullues i hollësishëm, përfshinë një sipërfaqe prej S=110.00 Ha. Parcelat që bëjnë pjesë në këtë zonë shtrihen në kuadër të zonës kadastrale Gllogoc.

**Neni 5**

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja, si dhe 7 ditë nga publikimi në Web faqen zyrtare të Komunës.

Plani i dërgohet:
Vendimi i dërgohet:
Zyrës së Kryetarit ;
Drejtorisë Përkatëse;
Zyrës së Kuvendit;
Arkivit

...esuesi i Kuvendit të Komunës

...ilaim Hajdari

2

Vendim për Themelimin e Ekipit Komunal për Planifikim dhe Menaxhim Hapësinor

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova-Republic of Kosovo
**Komuna e Gllogocit**
Zyra e Kryetarit
**01-Nr**-930/01-4/1288**dt.** 08/08/ **2022**

Në bazë të nenit 13, nenit 17 shkronja (b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 5 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 pika 1.2.3, nenin 11 dhe 17 të Ligjit Nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, Kryetari i Komunës së Gllogocit, merr këtë:

**VENDIM**
**PËR THEMELIMIN E EKIPIT KOMUNAL PËR PLANIFIKIM DHE MENAXHIM HAPËSINOR**

**I.** Formohet Ekipi komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor për hartimin e Planeve Rregulluese të Hollësishme në Komunën e Gllogocit, në këtë përbërje:

1. Flutura Avdiu, Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit
2. Endrit Gllareva, Drejtoria e Infrastrukturës Lokale
3. Besart Bajrami, Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit
4. Adhurim Hoxha, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë
5. Fadil Tahiri, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë
6. Shukrie Azizi, Drejtoria e Inspekcionit
7. Ksamil Ramadani, Drejtoria për Zhvillim Ekonomik
8. Muhamet Gjoka, Drejtoria Komunale e Arsimit
9. Albulena Lushtaku Hetemi, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
10. Shpend Bogiqi, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport
11. Ahmet Ahmeti, Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural
12. Enver Hoxha, Drejtoria për Buxhet dhe Financa
13. Florim Hajdari, KEDS
14. Kastriot Berisha, Kompania Rajonale e Mbeturinave ''Pastrimi''
15. Bujar Imeri, KRU ''Prishtina''
16. Arton Qorri, Arkitekt
17. Arben Kuliqi, Shoqëria civile

**II.** Detyrë e Ekipit komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor është që të sigurojnë të dhënat nga drejtoritë sektoriale dhe burimeve njerëzore brenda komunës, të marrin pjesë në takime të rregullta konsultative për hartim të Planeve Rregulluese të Hollësishme, të japin ekspertizë profesionale në analiza sektoriale dhe hapësinore, të informojnë vendimmarrësit për procesin e hartimit të planeve rregulluese të hollësishme,të inkorporojnë komentet e dhëna nga qytetaret në shqyrtimin publik, dhe të procedojnë miratimin përfundimtar të planeve rregulluese të hollësishme në kuvendin e komunës.

**III.** Ky vendim hyn në fuqi, në ditën e nënshkrimit nga ana e Kryetarit të Komunës.

REPUBLIKA E KOSOVËS – KOMUNA GLLOGOC – REPUBLIC OF KOSOVO – MUNICIPALITY GLLOGOC

Kryetari i Komunës

Ramiz Lladrovci

Vendimi i'u dërgohet:

- *Zyrës së Kryetarit;*
- *Anëtareve të Ekipit komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor;*
- *Arkivit;*

## Procesverbal i hapjes së shqyrtimit publik të Planit Rregullues Urban për qendren e qytetit të Gllogocit

Kryetari i Komunës së Drenasit Ramiz Lladrovci, së bashku me Drejtoreshën e Planifikimit Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit, Flutura Avdiu, përfaqësuesin e kompanisë hartuese INSI shpk, Ismajl Baftijari, kanë bere hapjen zyrtare të shqyrtimit publik të Projekt dokumentit Plani Rregullues i Hollësishëm për Qendrën e Qytetit Gllogoc.

Qëllimi i këtij prezantimi eshte që të zhvillohen konsultime dhe që të inkurajohet pjesëmarrja transparente e publikut në procesin e hartimit të këtij dokumenti të planifikimit hapësinor që përcakton kushtet për rregullimin e hapësirave për zona urbane apo zona rurale siç është përcaktuar në Planin Zhvillimor Komunal dhe Hartën Zonale Komunale për një periudhë së paku 8 vjeçare. Kryetari Lladrovci u shprehur se është i lumtur që gjatë qeverisjes së tij ka arritur të miratojë dy dokumentet me të rëndësishme të planifikimit hapësinor siç janë Plani Zhvillimor i Komunës së Gllogocit 2020-2028 dhe Harta Zonale e Komunës së Gllogocit 2022-2030, tashmë edhe Planin Rregullues të Hollësishëm për Qendrën e Qytetit, duke kompletuar kështu legjislacionin në fushën e planifikimit hapësinor.

Kryetari Lladrovci falënderuaroj kontribuesit e hartimit të Planit Rregullues të Hollësishëm për Qendrën e Qytetit, Ekipin Komunal të Planifikimit Hapësinor, kompaninë hartuese INSI shpk për dhënien e kontributit gjatë procesit të hartimit të Planit Rregullues të Hollësishëm.

Gjatë periudhës së shqyrtimit publik qytetarët e Komunës së Drenasit do të kenë mundësi që të japin vërejtjet, komentet dhe sugjerimet, të cilat pastaj do të inkorporohen në dokumentin e Planit Rregullues të Hollësishëm për Qendrën e Qytetit Gllogoc.

Gjithashtu drejtori I kompanisë INSI shpk shpalosi punen e deri tanishme të hartimit të Planit Rregullues të Hollësishem për qendren e qytetit ku shtoj se përkunder kufizimeve qe ka zona është bërë zgjidhja më e mirë e mundëshme për shfrytëzimin e hapsirës, për plotësimin më të gjitha permbajtjet ka nevoj qendra e Drenasit.Pas gjithë fjalimit falenderoj për bashkëpunim komunen e Drenasit si dhe Kryetarin Z.LLadrovci

Më pas perfaqesuesi I kompanis INSI shpk arkitekt Rrustem Bahtiari mori fjalën për të bërë prezantimin e draftit të Planit rregullues të hollësishem, ku permendi që forma ligjore na obligon që hartimi i dokumentit të jetë I bazuar në hartimin e dokumenteve të planifikimit hapsinor për tërë teritorin e Komunes ,gjithëashtu kemi obligim ta bejem digjitalizimin e te dhenave te panifikimit hapsinor si baze te monitorimit dhe hartimit te zbatimit te dokumentave te planifikimit hapsinor qe te jemi konform normave teknike te planiifikimit hapsinor si baze unifikuese e hartimit dhe zbatimit e dokumentave te planifikimit hapsinor.

Me lejen e drejtoreshes së Planifikimit Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit, Flutura Avdiu filloj debate ku mori

fjalen Arkitekti Agron Kuliqi perfaqsuesi I Metrica studio zyre projektimi ku parashtroj pytjen per profilet e rrugeve nese ne nje bllok urban te cilin do te kemi nje koncesion per ndertim na krijohen nevojat per shtigje te reja te rrugeve si do te mund ti krijojm ato dhe a do te mund ti shfrytezojm te njejtat rruge per te krijuar mundesi per shfrytezim te bunuseve te zonimit apo si eshte organizuar kjo?
Pergjigjen e kesaj pytje e mori nga Drejtori I ISNI :profilet e rrugeve edhe vija rregulluese ,vija ndertimore kane qene sfida qe ne si kompani I kemi marr si gjendje reale ne teren dhe nga kerkesat qe vijn nga norma e planifikimit hapsinor ,na është dashur ti shohim ndertese për ndertese qe ta bejm profilin e rrugeve te cilat jane kryesore urbane dhe sekondare urbane me to definohen blloqet,Brenda blloqeve ka me pas fleksibilitet te mjaftueshem nese blloku zhvillohet me nje cilesi te caktuar ,rruget mbrenda bllokut kane me u definu baze zgjidhjeve qe behen mbrenda bllokut ,dmth rruget mbrenda bllokut nuk jane te kufizuara,por normal rruget kryesore rruget sekondare urbane qe jane zona te cilat e bejen edhe ndarjen mes blloqeve,edhe pse sfida me te mdhaja kan qene normat e planifikimit hapsinor kerkojn gjersi dhe standarde te caktume te rrugeve ,duke pasur parasysh nje pjese e zones eshte e ndertune ,nuk eshte bere nje studim I fizibilitetit paraprak se sa ja vlen qe te zhvillohen zonat dhe cilat zona ja vlen me I zhvilllu.
Kryetari Ramiz Lladrovci theksoi se per bunuse jemi duke bere nje rregullore por se eshte e veshtir ti jepet nje pergjigje se si ka me qene qeshtja e bunuseve,ndersa qeshtja e rrugeve te zonat e mesme e ndertimit te zonat tjera nuk mundemi ti shpronsojm ne sepse komuna nuk ka buxhet per kete sherbim ,prandaj kur te arrihet marreveshja pronaret duhet ta kene parasysh se rruget do te behen nga ana e tyre,dhe Komuna nuk do te leshoj as nje leje pa I plotesuar te gjitha kushtet e ndertimit .
Gjate debatit fjalen e mori Arkitekti Hamdi Qorri ku pergezoj dhe falenderoj Komunen e Drenasit dhe Krytarin Ramiz Lladrovci per perpjekjen dhe perkushtimin e vazhdushem qe edhe komuna e Drenasit te kete nje Plan Rregullues te Hollesishem.
Kryetari theksoi qe ne baze te ketij Plani pas 2 muajve eventualisht 3 muaj do te fillojn ndertimin e sheshit te ri me grandin e performances te fituar 2.35M euro dhe nuk do te lejoj qe te kete vrazhdesi apo ndertime te pambaruara ne qytetin e Drenasit,gjithashtu te gjindet zgjidhja per objektet aktuale te cilat prishin imazhin e Qytetit .
Nje pytje u parashtru edhe nga Habib Mulaj ku kerkoj te informohet rrethe infrastruktures nentoksore te qendres,ujrave te zeza ,ujesjellsit,kanalizimit.

Pergjigje: Kryetari I komunes dhe ja beri me dije se te gjitha keto hapa jan ndermarrur me kohe.ne kete pytje u pergjigjë edhe drejtori I INSI ku tregoj qe jan skanuar te gjitha gjendjet aktuale te profilit te zone te ciles eshte pregaditur Plani rregullues I hollsishem,pjesa e planifikune kryesisht eshte marrur nga dokumentat te nivelit me te lart,Harta zonale trajton komplet zonen Urbane dhe zonat Rurale, ku te gjitha projektet jane ne dispozicion qe jane planifikuar per te ardhmen qofte per ngritje te kapacitetit te tubave apo gypave per furnizim me uje ,qofte kanalizim ,dhe rrjetit per energjetik
Me tutje pytje u parashtru nga Arben Nika qytetar I komunes se Drenasit,dhe perfaqesues I organizates CD,kerkoj nga kryetari I drenasit te shpronsohen disa prona te cilat kan mbetje arterie ,qe ti jepet nje zgjedhje ketyre zonave dhe plani rregullues te marre kuptim te plote,gjithashtu per te ardhemen qe te kete zgjidhje te mira dhe qyteti te marre fryme ,ceki rrugen Antigona Fazliu ku jane disa pengesa dhe te ndermerret diqka qe keto rruge te jene funksionale.
Kryetari LLadrovci ritheksoj se po e bejn rregulloren e bonuseve per kete ceshtje sigurisht mbi bazen e ligjit.

Me pas Drejtoresha kerkoi nese dikush ka pytje ,dhe keshtu u permbylle shqyrtimi I Planit rregullues te hollsishem me pytjet dhe diskutimet e lartecekura.

## Përmbledhja e komenteve, rekomandimeve dhe vërejtjeve të aktiviteteve të shqyrtimit publik

Tabela e komenteve:

| **Data** | **Parashtruesi** | **Lokacioni i parcelës** | **Komenti/ vërejtja** | **Aprovohet /refuzohet** | **Arsyetimet për miratim apo refuzim të porpozimeve dhe vërejtjeve të qytetarëve.** |
|---|---|---|---|---|---|
| 23.03.2023 | Dea Center | 01058-0 | Bazuar në Draftin e PRRH, në kuader të planit të riparcelimit në zonën e bllokut në parcelën kadastrale 01058-0 zk. Gllogoc parashihet të ketë ndarje të blloqeve ne formate ndryshme që nuk përshtaten me këtë parcelë, andaj kërkojmë që në kuadër të blloqeve urbane në këtë zonë të përfshihet e tërë parcela që të mund ta zhvillojme projektin në terësinë e parceles. | Aprovohet | Ekipi Komunal i Planifikimit, pas shqyrtimit të kërkesës suaj ka konstatuar si në vijim:<br>Aprovohet kërkesa juaj sa i përket planit të riparcelimit pasi që nuk bie në kundërshtim me kushtet e zhvillimit të bllokut urban, si dhe kërkesa juaj për rritjen e shfrytëzimit të sipërfaqes nëntokësore SNP të jetë 80%, poashtu keni fleksibilitet në krijimin e rrugëve qasëse brenda bllokut.<br>Refuzohet kërkesa juaj sa i përket mos-kufizimit të lartësis dhe etazhitetit maksimal të objektet të banimit të lartë. Etazhiteti maksimal do të jetë P+10. |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 23.03.2023 | Metric Architecture Studio | 01058-0 | Bazuar në Draftin e PRRH, në kuader të planit të riparcelimit në zonën e bllokut në parcelën kadastrale 01058-0 zk. Gllogoc parashihet të ketë ndarje të blloqeve ne formate ndryshme që nuk përshtaten me këtë parcelë, andaj kërkojmë që në kuadër të blloqeve urbane në këtë zonë të përfshihet e tërë parcela që të mund ta zhvillojme projektin në terësinë e parceles. | Aprovohet Pjesërisht | Ekipi Komunal i Planifikimit, pas shqyrtimit të kërkesës suaj ka konstatuar si në vijim:<br>Aprovohet kërkesa juaj sa i përket planit të riparcelimit pasi që nuk bie në kundërshtim me kushtet e zhvillimit të bllokut urban, si dhe kërkesa juaj për rritjen e shfrytëzimit të sipërfaqes nëntokësore SNP të jetë 80%, poashtu keni fleksibilitet në krijimin e rrugëve qasëse brenda bllokut.<br>Refuzohet kërkesa juaj sa i përket mos-kufizimit të lartësis dhe etazhitetit maksimal të objektet të banimit të lartë. Etazhiteti maksimal do të jetë P+10. |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 23.03.2023 | Metric Architecture Studio | 00408-12, 00409-1, 00409-3, 00409-4, 00409-5, 00409-8, 00409-9, 00409-10, 00410-9, | Bazuar në Draftin e PRRH, në kuader të planit të riparcelimit në zonën e bllokut në parcelat kadastrale 00408-12, 00409-1, 00409-3, 00409-4, 00409-5, 00409-8, 00409-9, 00409-10, 00410-9, zk. Gllogoc parashihet të ketë ndarje të blloqeve ne forme që nuk përshtaten me mënyrën e planifikuar për zhvillimin e këtyre parcelave, andaj kërkojmë që në kuadër të blloqeve urbane në këtë zonë të përfshihen këto parcela. Ndër kriteret e përcaktuara me Hartë Zonale Komunale (HZK) i cili tangon gjithashtu ndërtimin në përgithesi është edhe përqindja e sipërfaqes nëntoksore të parceles SNP (60% sipas HZK). Ky kriter në përgjithësi vështirson dhe pamundëson krijimin e njësive të nevojshme të parkimit, për të permbushur kriterin e percaktuar me HZK, andaj, ne kërkojme që bazuar në nevojen e kompleksit për më tepër njësi parkimi përqindja e sipërfaqes nëntokësore të parceles SNP të jetë të paktën 80%, përqindje kjo e cila do ishte optimale.<br>Gjithashtu njëra ndër pikat kyqe në zhvillimin e blloqeve te ndërtimit është edhe percaktimi i etazhitetit. Ne qoftë se do duhej të minimizohet mundësia për t'u ngritur në lartësi nderkohe që ne shfrytëzojme me pak të drejtën për t'u zgjeruar në etazhet e larta (me pak se 40%) atëhere kjo do cenonte edhe kreativitetin dhe zhvillimin e projektit në tërësi. Prandaj, propozojmë që zhvillimi i etazhitetit të jetë fleksibil, duke variruar në vartesi të zhvillimit të arkitektures | Pjesërsiht | Ekipi Komunal i Planifikimit, pas shqyrtimit të kërkesës suaj ka konstatuar si në vijim:<br>Aprovohet kërkesa juaj sa i përket planit të riparcelimit pasi që nuk bie në kundërshtim me kushtet e zhvillimit të bllokut urban, si dhe kërkesa juaj për rritjen e shfrytëzimit të sipërfaqes nëntokësore SNP të jetë 80%, poashtu keni fleksibilitet në krijimin e rrugëve qasëse brenda bllokut.<br>Refuzohet kërkesa juaj sa i përket mos-kufizimit të lartësis dhe etazhitetit maksimal të objektet të banimit të lartë. Etazhiteti maksimal do të jetë P+10. |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 03.03.2023 | Banorët e Rruges Selman Demiqi, me perfaqesues Elmaz Elshani | Rr. Selman Demiqi | Me qëllim të informimit të komunës së Gllogocit dhe drejtorive përkatëse të saj në lokacionin Lagjen e Drenasi 1, rruga Selman Demiqi, në të cilën është realizuar projekti I shtëpive banimore të pronarëve privat i tipit te ndertimit te ulët, te giitha te realizuara sipas lejeve per ndërtim dhe kushteve urbanistike te lejuara nga Komuna e Gllogocit. Ne kete lagje-zone te ndertimit individual te shtepive te tipit te ndertimit te ulet, pronarët privat nga pronat e tyre kanë ndertuar rrugen me gjerësi prej 4m dhe gjatesi 300m, kryesisht për nevojat dhe çasjen e ketyre pronarëve , dhe e njejta eshte ne emër tē pronareve privat. Pēr zgjerimin e saj për 8m, duhet te rrënohen disa shtepi banimi, mure e infrastrukture tjeter dhe kjo mund te behet vetem me shpronesimin e ketyre pronave , kompensimin e tyre ne perfillie të Ligjit pêr Shpronesim. Por para se gjithash cili eshte interesi publik per kete? ! Apo zoteron interesi privat - biznesor ? Nē te dy anet e kesaj rruge jane realizuar 90% e ndertimeve te shtepive te ndertimit te ulet dhe nuk ka asnje mundesi tē zgjerimit te kesaj rruge ne pronat e pronarëve privat ne te cilat eshte realizuar projekti i tyre ne detaje sipas kushteve urbanistike dhe lejes se ndertimit te lēshuara nga Komuna. Infrastruktura perciellese si kanalizimi dhe ujesjellësi eshte investim privat i ketyre pronarëve të shtēpive te ndertimit te ulet dhe ka kapacitet te kufizuar . Andaj me gellim te konstatimit te plote te | Aprovohet Pjesërisht | Autoriteti komunal i Planifikimit Hapësinor mirëpret komentet dhe vërejtjet tuaja si qytetar dhe banorë të rrugës “Selman Demiqi” dhe njëkohësisht ju bëjmë me dije se duke u bazuar në komentin tuaj, planifikimi i zonës për të cilën është dhënë komenti është bërë më Hartën Zonale të Komunës së Gllogocit 2022-2030 dhe kjo zonë është paraparë të jetë zonë e banimit të lartë. Sa i përket zgjerimit të rrugëve ju informojmë se më planin rregullues parashihet vendosja e vijës rregulluese dhe vijës ndërtimore me të cilat caktohet edhe gjerësia e planifikuar e kësaj rruge, kurse pjesa e shpronësimit zgjidhet me ligjet tjera në fuqi. |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | gjendjes faktike dhe mos cenimit të drejtave pronësore, banimore e funksionale te banorëve te shtepive te ndertimit te ulet dhe degradimit te kesaj lagje- pjese te gytetit, kërkojme qe te merret parasysh verejtjet tona, te inspektohet kjo lagie ne teren e pastaj të behet planifikimi ne perputhje me gjendjen faktike në teren. Pjese perbërëse e ketyre verejtjeve me shkrim te Projekt dokumentit- Plani Rregullues i Hollēsishem per Qendren e Qytetit Gllogoc, është edhe Peticioni i banoreve - pronareve te shtēpive te ndertimit tê ulet te kesaj lagje ,i dt. 01.12.2022, i cili eshte dorëzuar ne Komunen e Drenasit fizikisht , i cili tani bashkëngjitet shtojce. Kērkoim qe të pezullohen punimet e pa ligishme ne këte lagje deri ne miratimin e Planit te Hollesishëm për Qendrën e Qytetit Gllogoc dhe  pershtatjen me kushtet urbanistike e ligjore. | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 05.04.2023 | Sanerd SHPK | 799-3,799-4, 798-3, 798-14, 798-15, 798-7 | Kërkesë për Zhvillimi të Bllokut Urban në parcelat 00799-3, 00799-4, 00798-3, 00798-14, 00798-15, 00798-7, në të cilat propozohet që të bëhet: Lidhja e rrugës Bajram Dobra me rrugën Xhevat Demaku, Rruga e propozuar e katogorise 3 që kalon në mes të bllokut që lidh rrugën Antigona Fazliu me rrugën Ramadan Bytyqi është propozuar që të mos hiqet por vetëm të zhvendoset dhe të kthehet në rrugë brenda bllokut. Në rrugët e kategorise 2 për objektet me funksion në përshtatshmëri vija ndërtimore është 7.5m nga aksi i rrugës të së specifikuar ne situacion. Në rrugët e kategorisë III, për objektet me funksione në përshtatshëmri vija ndërtimore 7.5m nga aksi i rrugës ( të specifikuara në situacion) | Aprovohet | Ekipi Komunal i Planifikimit, pas shqyrtimit të kërkesës suaj ka konstatuar si në vijim:<br>Aprovohet kërkesa si e bazuar, pasi që nuk bie në kundërshtim me kushtet e zhvillimit të blloqeve urbane dhe është në shërbim të rregullimit urban dhe mirë funksionimit të sistemit të rrugëve, poashtu aprovohet kërkesa juaj për rritjen e shfrytëzimit të sipërfaqes nëntokësore SNP të jetë 80%. |
| 06.04.2023 | Hamdi Qorri | QKMF Drenas | Planfikim I rruges urbane | Aprovohet | Ekipi Komunal i Planifikimit, pas shqyrtimit të kërkesës suaj ka konstatuar si në vijim:<br>Aprovohet kërkesa si e bazuar, pasi që nuk bie në kundërshtim me kushtet e zhvillimit të blloqeve urbane dhe është në shërbim të rregullimit urban dhe mirë funksionimit të objektit të planifikuar të QKMF-së. |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 06.04.2023 | Drejtoria e Infrastruktures | Qendra e Qytetit | Komente per rruget, kanalizimi fekal, atmosferik dhe rrjeti elektrik | Aprovohet | Ekipi Komunal i Planifikimit, pas shqyrtimit të kërkesës suaj ka konstatuar si në vijim:<br>Aprovohet kërkesa si e bazuar, pasi që komentet dhe vërejtjet tuaja do të jenë në shërbim të planifikimit të mirëfillt, sepse ju jeni në dijeni me të gjitha problemet me të cilat përballen qytetarët e hapësirës urbane. |
| 07.04.2023 | DPUMM | Qendra e Qytetit | Komente ne funksion te vazhdimesis se planeve te miratuar aktuale dhe permbatjeve te qytetit | Aprovohet | Ekipi Komunal i Planifikimit, pas shqyrtimit të kërkesës suaj ka konstatuar si në vijim:<br>Aprovohet kërkesa si e bazuar, pasi që komentet dhe vërejtjet tuaja do të jenë në shërbim të planifikimit të mirëfillt, duke marrur parasyshë përvojën në hartimin, monitorimi dhe zbatimin e dokumenteve të planifikimit hapësinor. |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 07.04.2023 | BA Construction Sh.p.k. | 01052-0 | Kerkese per kushte te veqanta ndertimore për parcelën ndërtimore 01052-0 në Planin Rregullues të Hollësishëm | Aprovohet | Ekipi Komunal i Planifikimit, pas shqyrtimit të kërkesës suaj ka konstatuar si në vijim:<br>Se në këtë rast duhet vepruar sipas dispozitave të PRrH-së, konkretisht tek Përjashtimet, nëse me rastin e aplikimit për leje ndërtimore dëshmohet privimi nga mundësia e zhvillimit për një parcelë kadastrale. Për të dëshmuar privimin e tillë duhen dëshmuar këto pika:<br>- Karakteristikat e veçanta të tokës që e bëjnë të pamundur për aplikuesin t'u përmbahet të gjitha kushteve për rregullimin e hapësirës; - Përjashtimi kërkohet për shkak të gjendjes apo konfiguracionin unik të pronës, e jo kushteve të përgjithshme të lagjes apo sipërfaqes; -Përjashtimi nuk mund të ketë efekt dëmtues mbi mjedisin apo sipërfaqen rrethuese; - Privimi nuk është rezultat i veprimit të ndërmarrë nga pronari i tokës apo një pronar i mëparshëm; -Përjashtimi nuk mund të krijojë ndikime negative në pronat fqinje apo pronat e tjera në afërsi duke ndikuar tek: Diellzimi dhe ajrosja e pronave fqinje;<br>- Trafik të shtuar dhe vështirësi në lëvizshmëri të trafikut publik dhe korridoreve të infrastrukturës në afërsi; - Siguri publike duke përfshirë dhe rritjen e rrezikut nga zjarri apo rreziqet tjera të mundshme; - Vlerat e |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | pronave fqinje;  dhe shfrytëzim dhe zhvillim të pronave fqinje. |
| 07.04.2023 | Muharrem Shala | 01006-0 | Kerkese per rregullim te riparcelimit per parcelen 01006-0 | Aprovohet | Ekipi Komunal i Planifikimit, pas shqyrtimit të kërkesës suaj ka konstatuar si në vijim:<br>Aprovohet kërkesa si e bazuar, pasi që nuk bie në kundërshtim me kushtet e zhvillimit të bllokut urban. |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 07.04.2023 | Korabi Construction | 01053-0, 00408-5 | Kerkeser per perfshirje brenda se bashku brenda planit te riparcelimit | Aprovohet | Ekipi Komunal i Planifikimit, pas shqyrtimit të kërkesës suaj ka konstatuar si në vijim:<br>Aprovohet kërkesa si e bazuar, pasi që nuk bie në kundërshtim me kushtet e zhvillimit të bllokut urban. |
| 07.04.2023 | Mehdi Gjoka | 01039-0 | Kerkese per rregullim te riparcelimit per parcelen 01039-0 | Aprovohet | Ekipi Komunal i Planifikimit, pas shqyrtimit të kërkesës suaj ka konstatuar si në vijim:<br>Aprovohet kërkesa si e bazuar, pasi që nuk bie në kundërshtim me kushtet e zhvillimit të bllokut urban. |
| 07.04.2023 | Ahmet Gllareva | 00795-9, 00795-12, 00795-11, 00795-14 | Kerkeser per perfshirje brenda se bashku brenda planit te riparcelimit | Aprovohet | Ekipi Komunal i Planifikimit, pas shqyrtimit të kërkesës suaj ka konstatuar si në vijim:<br>Aprovohet kërkesa si e bazuar, pasi që nuk bie në kundërshtim me kushtet e zhvillimit të bllokut urban. |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
